

**VENDIM**  
**Nr.78, datë 8.2.2006**

**PËR KRIJIMIN E MATURËS SHTETËRORE DHE PRANIMET NË SHKOLLAT E LARTA PUBLIKE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 63 të ligjit nr.7952, datë 21.6.1995 “Për sistemin arsimor parauniversitar”, të ndryshuar, të nenit 31 të ligjit nr.8461, datë 25.2.1999 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të ligjit nr.9464, datë 28.12.2005 “Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2006”, me propozimin e Ministrit të Arsimit dhe të Shkencës, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1. Krijimin e maturës shtetërore, e cila realizon provimet e pjekurisë në përfundim të arsimit të mesëm 4 dhe 5-vjeçar, nëpërmjet vlerësimit të jashtëm. Matura shtetërore të përbëhet nga:

- a) provime të detyruara,
- b) provime me zgjedhje.

2. Arsimi i mesëm quhet i përfunduar kur nxënësi arrin rezultate kaluese në provimet e detyruara.

3. Kanë të drejtë të kërkojnë që të vazhdojnë studimet në shkollat e larta publike, vetëm ata kandidatë, të cilët kanë kryer provimet e maturës shtetërore ose ekuivalentet e saj, për nxënësit, që kanë kryer arsimin e mesëm jashtë vendit.

4. Ngritjen e Komitetit të Maturës Shtetërore, pranë Ministrisë së Arsimit dhe të Shkencës, për drejtimin dhe organizimin e provimeve të maturës shtetërore, përbërja dhe detyrat e të cilit caktohen me urdhër të Ministrit të Arsimit dhe të Shkencës.

5. Pranimet në shkollat e larta publike, si rregull, të mbështeten në rezultatet e shkollës së mesme, sipas kësaj skeme:

- a) 20 për qind në notën mesatare të të gjitha viteve të shkollës së mesme;
- b) 80 për qind në mesataren e notave të provimeve të maturës shtetërore.

6. Për vitin 2008 e në vazhdim pranimet në shkollat e larta publike, si rregull, të mbështeten në rezultatet e shkollës së mesme, sipas kësaj skeme:

- a) 35 për qind në notën mesatare të të gjitha viteve të shkollës së mesme;
- b) 65 për qind në mesataren e notave të provimeve të maturës shtetërore.

7. Përzgjedhja e kandidatëve për t’u pranuar në shkollat e larta publike të mbështetet në kriteret e përgjithshme, të hartuara nga Ministria e Arsimit dhe e Shkencës, pas këshillimit me shkollat e larta publike. Këto shkolla mund të përcaktojnë kriteret e veçanta, në përputhje me kriteret e përgjithshme. Për kriteret e veçanta duhet të merret mendimi i Ministrisë së Arsimit dhe të Shkencës.

8. Për shkollat e larta ushtarake dhe për shkollat e larta të policisë kriteret e veçanta vendosen nga Ministri i Arsimit dhe i Shkencës dhe, përkatësisht, nga Ministri i Mbrojtjes e nga Ministri i Brendshëm, në përputhje me nenet 2, 3 e 8 të kreut I, të ligjit nr.8461, datë 25.2.1999 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar.

9. Efektet financiare:

a) për provimet e maturës shtetërore, të mbulohen nga buxheti i Ministrisë së Arsimit dhe të Shkencës dhe nga tarifa e provimit me zgjedhje;

b) për pranimet e kërkesave për studim në shkollat e larta publike, të mbulohen nga buxheti i shkollave të larta dhe nga tarifa përkatëse.

Tarifat e mësipërme të përcaktohen me urdhër të përbashkët të Ministrit të Arsimit dhe të Shkencës dhe të Ministrit të Financave.

10. Ngarkohet Ministria e Arsimit dhe Shkencës për zbatimin e këtij vendimi.

11. Të gjitha aktet nënligjore për provimet e pjekurisë, të parashikuara në kreun V të dispozitave normative për arsimin parauniversitar dhe urdhrat që mbështeten në to, të cilat bien në kundërshtim me këtë vendim, shfuqizohen.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTRI**  
**Sali Berisha**